Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0048

PSH. Nr. 0048/24; 0050/24; 0056/24; 0057/24; 0058/24; 0059/24

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e operatorit ekonomik (OE) "N.P. Victoria Invest International Sh.p.k.", ankesës e (OE) "RSM Company SH.P.K", ankesës së (OE) "Sallahu SH.P.K.", ankesës së (OE)"Granit" SH.P.K", ankesës së (GOE) "Ndërtimi Ing Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium; Adnan Bislimi B.I.; Adea Construction Sh.P.K.; Agim Morina B.I.; Riviera Company 2008; Ndregjoni", si dhe ankesës së (GOE) "N.N. 100 % Design Sh.P.K.; Haxha Kom Sh.P.K.; Haxha Company Sh.P.K.; Integral Sh.P.K.; Milenium Konstruction Sh.P.K.; Capital Sh.P.K" të parashtruara kundër Vendimit të datës 29.12.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve - Dollc, Loti 1, 2, 3, 4" me numër të prokurimit: "205-23-1843-5-1-1", të Ministrisë së Infrastrukturës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) me 19.03.2024, mori:

Vendim

1 Aprovohen si pjesërisht të bazuara, ankesa e OE "Sallahu SH.P.K." e datës 18.01.2024 (Nr. 2024/0056), ankesa OE "Granit" SH.P.K" e datës 18.01.2024 (Nr. 2024/0057), ankesa e GOE "Ndërtimi Ing Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium; Adnan Bislimi B.I.; Adea Construction Sh.P.K.; Agim Morina B.I.; Riviera Company 2008; Ndregjoni" e datës 18.01.2024 (Nr. 2024/0058), për pretendimet ankimore për LOT 1;

2. Refuzohen si të pabazuara, ankesa e OE "N.P. Victoria Invest International Sh.p.k." e datës 11.01.2024 (Nr. 2024/0048), ankesa e OE "RSM Company SH.P.K" e datës 15.01.2024 (Nr. 2024/0050), dhe ankesa e GOE "N.N. 100 % Design Sh.P.K.; Haxha Kom Sh.P.K.; Haxha Company Sh.P.K.; Integral Sh.P.K.; Milenium Konstruction Sh.P.K.; Capital Sh.P.K" e datës 18.01.2024 (Nr. 2024/0059).

3. Lejohet tërheqja e ankesës nga OE "Sallahu SH.P.K." e datës 18.01.2024 (Nr. 2024/0056), ndaj LOT 3.

4. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënien e kontratës i datës 29.12.2023, për LOT 2, LOT 3 dhe LOT 4, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve – Dollc Loti 1,2,3,4" me numër të prokurimit: "205-23-1843-5-1-1", të Ministrisë së Infrastrukturës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK).

5. Anulohet Vendimi i AK i datës 29.12.2023 për LOT 1, dhe lënda kthehet në Rivlerësim vetëm për LOT 1.

6. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore për ankuesit si në vijim: "N.P. Victoria Invest International Sh.p.k." (Nr. 2024/0048), "RSM Company SH.P.K" (Nr. 2024/0050), "N.N. 100 % Design Sh.P.K.; Haxha Kom Sh.P.K.; Haxha Company Sh.P.K.; Integral Sh.P.K.; Milenium Konstruction Sh.P.K.; Capital Sh.P.K" (Nr. 2024/0059). Mjetet e konfiskuara kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës ashtu sikurse parashikohet me nenin 31.5, Rregullores së Punës së OSHP.

7. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore për ankuesit si në vijim: OE "Sallahu SH.P.K." (Nr. 2024/0056), OE "Granit" SH.P.K" (Nr. 2024/0057), OE "Ndërtimi Ing Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium; Adnan Bislimi B.I.; Adea Construction Sh.P.K.; Agim Morina B.I.; Riviera Company 2008; Ndregjoni" (Nr. 2024/0058), subjektet ankuese, të renditur sipas këtij paragrafi, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sipas nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

8. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.03.2023, Ministria e Infrastrukturës, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijeve - Dollc, Loti 1, 2, 3, 4" me numër të prokurimit: "205-23-1843-5-1-1".

Me 24.04.2023, AK (me të dhëna si më sipër) përmes publikimit, i ka informuar palët e interesuara lidhur me korrigjimin e gabimeve të cilat i referohen njoftimeve paraprakisht të publikuara, ndërsa hapja e ofertave për ketë aktivitet të prokurimit është realizuar me 04.05.2023.

Me 29.12.2023, AK ka publikuar vendimin e tij/sajë për dhënie të kontratës, përkitazi me aktivitetin e prokurimit, i cili me datë, numër dhe emërtim është përshkruar tani më si më sipër ku janë rekomanduar për kontratë për Lot 1 - Grup i OE-ve "R & Rukolli"; "Saba Belca" Dega në Kosovë; "Elmazaj Konstruksion"; "Tekno - Konstrukt" SH.P.K.. Lot 2 - Grup i OE-ve "Empreus" SH.P.K.; "Jaha Company" sh.p.k.; "Premium - KS" SH.P.K.; "Toifor" Sh.p.k.; NNT "ABC" SH.P.K.; "Metag Insaat Ticaret" A.S., Lot 3 - Grup i OE-ve "Lika Trade" Sh.p.k.; "TOFI" doo; "Lika Company" SH.P.K. Lot 4 - Grup i OE "Famis Co-Hc" SH.A; "KIT-AK", "Gradnje", d.o.o.; "KAG - Asphalt Company" SH.P.K.

Me 03.01.2024, OE si në vijim "N.P. Victoria Invest International Sh.p.k.", OE "RSM Company SH.P.K", OE "Sallahu SH.P.K.", OE "Granit" SH.P.K", GOE "Ndërtimi Ing Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium;Adnan Bislimi B.I.;Adea Construction Sh.P.K.;Agim Morina B.I.;Riviera Company 2008; Ndregjoni", GOE "N.N. 100 % Design Sh.P.K.;Haxha Kom Sh.P.K.;Haxha Company Sh.P.K.;Integral Sh.P.K.;Milenium Konstruction Sh.P.K.;Capital Sh.P.K" kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim, të cilat janë refuzuar si të pa bazuara me Vendimin e AK të datës 09.01.2024.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së për dhënie të kontratës me datën 11.01.2024 ka parashtruar ankesë në OSHP OE "N.P. Victoria Invest International Sh.p.k." me Nr. (0048/2024), me datën 15.01.2024 ka parashtruar ankesë OE "RSM Company SH.P.K" me Nr. (Nr. 2024/0050), me datën 18.01.2024 OE "Sallahu SH.P.K." me Nr. (2024/0056), OE "Granit" SH.P.K" me Nr. (2024/0057), GOE "Ndërtimi Ing Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium;Adnan Bislimi B.I.;Adea Construction Sh.P.K.;Agim Morina B.I.;Riviera Company 2008; Ndregjoni" me Nr. (2024/0058) si dhe GOE "N.N. 100 % Design Sh.P.K.;Haxha Kom Sh.P.K.;Haxha Company Sh.P.K.;Integral Sh.P.K.;Milenium Konstruction Sh.P.K.;Capital Sh.P.K" me Nr. (2024/0059).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Duke ju referuar ankesave si më sipër, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim neni16 (Rastet e unifikuara) i Rregullores së cituar, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë që ti bashkoj Lëndët/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë konstatohet se:

→ Raporti i ekspertizës, i datës 21.02.2024, përmban rekomandimet si në vijim:

Të aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat e OE-ve ankues Nr. 48/24, Nr. 50/24, Nr. 56/24, Nr. 57/24, Nr. 58/24 dhe Nr. 59/24

Të anulohet Vendimi i AK i datës 29.12.2023 dhe të behet rivlerësimi për Lot 1 dhe Lot 4

Të mbetët në fuqi vendimi i AK i datës 29.12.2023 për Lot 2 dhe 3

Raportet e ekspertizës i përmbajnë elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe të njëjtit janë pranuar nga palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në ketë rast evidentohet se për ankesën Nr. 48/24, AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE nuk është deklaruar. Për ankesën Nr. 50/24, AK është pajtuar me rekomandimin e ekspertit ndërkaq OE nuk është pajtuar. Për ankesën Nr. 56/24, AK nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues ndërkaq OE është pajtuar. Për ankesën Nr. 57/24, AK është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërkaq OE nuk është pajtuar. Për ankesën Nr. 58/24, AK nuk është pajtuar, ndërsa OE është pajtuar pjesërisht. Për ankesën Nr. 59/24, AK nuk është pajtuar, ndërsa OE nuk është deklaruar.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në ketë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;

b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;

c. vlera e parashikuar e kontratës: 32,000,000.00 € (për të gjitha pjesët), vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

d. Kriteri i dhënies së kontratë është çmimi ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 6 të dosjes së tenderit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

a) Pohimet ankimore të OE "N.P Victoria Invest International SH.P.K" Nr. 0048/2024

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) në këtë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot 1 dhe Lot 2, rrjedhimisht pretendimet ankimore janë për këto Lote. OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, me pretendimet që lidhen me arsyet e eliminimit të OE ankues. AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kontratat e realizuara si dhe për arsyen tjetër sa i përket planit dinamik i cili nuk është, me ç'rast AK ka vlerësuar se kontratat e realizuara nuk janë në lëmin e kërkuar (asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve), si dhe plani dinamik nuk është sipas kërkesave të DT. Lidhur me lidhur me këto dy pretendime ankimore Eksperti sqaron se kontratat për subjektin Victoria Invest International Sh.p.k, Në lidhje me këtë sipas opinionit të KRPP-së përcaktimi i natyrës së kontratave të ngjashme është kompetencë ekskluzive e AK-së. Ndërsa në lidhje me kontratën dhe dëshminë e subjektit Victoria Invest Sh.p.k dëshmia e dorëzuar është vetëm një certifikatë mujore e pagesës dhe nuk është dëshmi konform kërkesës së AK-së për realizimin e projektit me të dhënat përkatëse. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar. Ndërsa, formulimi i kërkesës për planin dinamik është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundshëm", andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë i cili për AK është subjektiv në kuptimin e vlerësimit të këtij kriteri, si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë", prandaj çështja e aspektit "sa më i detajuar" është vlerësim subjektiv. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrën e detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të DT dhe ofertës dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast. Andaj, në bazë të këtyre konstatime rezulton se OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit nuk është i përgjegjshëm, pasi që kontratat e realizuara nuk i ka sipas kushteve të DT.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura ndaj AK se ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1. Paneli Shqyrtues vendos konform dispozita ligjore që mos të lëshohet në vlerësim të pretendimet ankimore të cilat nuk janë parashtruar me kohë gjatë fazës paraprake sipas autorizimeve të ligjvënësit ne kuptim të nenin 108/A dhe 109 të LPP-së lidhur me nenin 64.2 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nga OE ankues dhe të njëjtat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi pranë OSHP. Edhe pse Paneli Shqyrtues sqaron se shumica e këtyre pretendimeve ndaj OE të rekomanduar për kontratë për LOT 1 janë shqyrtuar në pretendimet ankimore të OE tjerë ankues. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu

edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

b) Pohimet ankimore të OE “Rsm Company Sh.P.K.” Nr. 0050/2024

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) në pretendimin 1 thekson se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me marrëveshjen për themelimin e grupit dhe se udhëheqës (lider) i grupit është anëtari-OE “Groma Hold EOOD”. Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti sqaron se provat shkresore të dorëzuara nga GOE janë kundërthënëse. Me qëllim të përmbushjes së kërkesës të përcaktuar në nenin 11.1, pika c), të FTD-së, në lidhje me krijimin e grupit të OE-ve, është dorëzuar dokumenti i autorizimit ku thuhet se: autorizohet z.Agim Kola (d.m.th. pronari por jo partneri kryesor sikurse përcaktohet në kërkesë) që të veprojë në emër të grupit, për të gjitha veprimet e nevojshme, nënshkrimin e tenderit dhe çdo dokumentacion në lidhje me tenderin. Në anën tjetër në lidhje me plotësimin e kërkesës numër 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit, ku kërkohet që lideri i grupit duhet te ketë min. 40% te mbështetjes bankare, GOE ka dorëzuar deklaratën e bankës të lëshuar nga Investbank AD përshkruhet se anëtari “GROMA HOLD EOOD” ka fondet e veta në llogarinë bankare në Investbank në shumën mbi dy milionë euro për financimin e procedurës së tenderit dhe se referenca bankare shërben për Ministrinë e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, për pjesëmarrjen e kompanisë si grup i përbashkët Groma Hold EOOD partner kryesor - 52% dhe RSM Company SHPK - 48%. Poashtu, në pretendimet ankimore në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë OE ankues thekson se anëtari i grupit Groma Hold EOOD është lider i grupit. Më tej, anëtarët e grupit sikurse është sqaruar me lartë kanë dorëzuar deklaratat ndaras në lidhje me kërkesën e përcaktuar në nenin 11.1, pika a) e FTD-së. Në të dy deklaratat mungon pjesa e fundit e tekstit të kërkesës “në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës”. Në kontratën e noterizuar për krijimin e grupit, të nënshkruar nga palët thuhet se kontrata do të ekzekutohet nëpërmjet partnerit RSM Company Sh.p.k dhe se Groma Hold EOOD, në cilësinë si partner në grup, të kryejë vetëm dhe ekskluzivisht shërbime konsulence për ekzekutimin e kontratës me klientin dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me ekzekutimin e kontratës. Andaj, sipas sqarimit të mësipërme, dështmitë e dorëzuara nga GOE nuk janë konform kërkesave të nenit 72 paragrafi 3 i të LPP-së, Nenit 26, paragrafi 1, i Rregullores për Prokurim Publik dhe kërkesës e përcaktuar në nenin 11., pika a) të FTD-së. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar. Po ashtu, në pretendimin 2 ankimor OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me planin dinamik. Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues e ka klasifikuar si pjesërisht të bazuar.

Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrën e detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të DT dhe ofertës dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast se oferta e OE ankues përmban mangësi të cilat mund të ndikojnë direkt në ekzekutimin e kontratës. Andaj, paneli shqyrtues i mbështet konstatimet e ekspertit shqyrtues, ku rrjedhimisht OE ankues rezulton të jetë i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

c) Pohimet ankimore të OE “Sallahu” SH.P.K Nr. 0056/2024

Parashtruesi i ankesës (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar ofertë për Lot 1, Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4. OE ankues me datë 05.02.2024 ka ngarkuar shkresën përmes të cilës tërheq pretendimet ankimore lidhur me Lot 3.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të dhëna nga AK në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar:

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) në pretendimin 1 pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me pajisjet. Sa i përket këtij pretendimi ankimor Eksperti shqyrtues ka sqaruar se nga 5 pajisjet – Greder të paraqitur në listën e pajisjeve, sipas dëshmive të dorëzuara, pajisja me numër rendor 1 ka peshën 16200 kg apo 16.2T që është jashtë intervalit të paraqitu nga AK për peshën e pajisjes 12-16T. OE ankues në lidhje me këtë pozicion në ankesë pretendon se fakti që pajisja tejkalon për 200 kg peshën nuk ka ndikim në kryerjen e funksionit dhe cilësisë se tij dhe AK është dashur që konform nenit 59 të LPP-së paragrafi 4 të pranojë si devijim të vogël duke marr për bazë edhe dallimin në çmim me GOE të rekomanduar për Lot 1 e që është me shtrenjtë për 233,128.00 euro me e shtrenjte se oferta e OE ankues. Në lidhje me këtë pikë eksperti sqaron se, në raport me peshën totale është evidente dallimi minimal. Megjithatë eksperti nuk mund të konstatojë pranimin e devijimit meqë kjo është përgjegjësi e AK-së dhe në rast të rivlerësimit, AK mundet që të vlerësojë sa janë të pranueshme devijimet konform nenit 59 të LPP-së me kushtin që devijimet të kuanitifkohen dhe OE-të të trajtohen barabartë për të gjithë sipas nenit 7 të LPP-së. Në lidhje me pajisjen me numër rendor 3 (marka O&K, tip 106A) dhe 4 (Caterpillar 120M2) sipas dokumenteve të dorëzuar me ofertë nuk mund të vërtetohet pesha e pajisjeve. Në lidhje me pajisjen numër rendor 3 OE ankues në ankesë ka bashkangjitur si provë një imazh nga kërkimi në internet ku shihet pesha prej 12T, megjithatë, eksperti rekomandon që paneli shqyrtues të kërkojë nga AK që konform nenit 72 të LPP-së për këto pajisje të kërkojë sqarimet shtesë në mënyrë që të vlerësohet përmbushja e kërkesave. Andaj pretendimi ankimor është i pjesërisht i bazuar në këtë pikë sipas ekspertit shyqrtues..

Paneli sqaron se ky lëshim i bërë nga ankuesi *OE "Sallahu" SH.P.K* lidhur "*mos identifikimi i pajisjeve te tyre*" është vërejtur edhe në një rast të mëparshëm, ku ai/ajo është eliminuar nga i njëjti Autoritet Kontraktues (AK), Ministria e Infrastrukturës, dhe ankesa e tij/saj është refuzuar gjithashtu nga OSHP. Paneli vëren se në asnjërin prej këtyre rasteve, as në atë kohë dhe as tani, ankuesi nuk ka sjellë si dëshmi dokumentacionin doganor për të përmbyllur çështjen dhe për të dëshmuar përgjegjshmërinë e tij si ofertues. Andaj Paneli vlerëson se në rrethana të tilla, vërehet një mungesë serioziteti nga ana e ankuesit ndaj autoriteteve publike siç është AK-MI, kur ai/ajo prezanton ofertën e tij/saj për të fituar një kontratë publike.

Sipas udhëzuesve për prokurim publik dhe rregullave për prokurim publik Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar ligjërisht të kërkojë informacione apo sqarime shtesë për çdo dokumentacion dhe në çdo rast. Sepse dokumentacioni i prezantuar nga ofertuesit duhet të jetë i plotë, i qartë dhe i verifikueshëm, kurse AK gjatë vlerësimit duhet të sigurojë që parimet e barazisë në trajtim, mos-diskriminimi, konkurrenca dhe transparenca të respektohen në tërësi. Në rastin konkret sipas komisionit profesional të vlerësimit brenda AK, ankuesi për katër nga pajisjet e prezantuara në ofertën e tij/saj nuk ka ofruar dokumentacion ashtu siç ishte kërkuar shprehimisht ne dosjen e tenderit [DT] dhe në njoftimin për kontratë [NJ.K], andaj si të tilla nuk

mund të pranohen për shkak paqartësisë dhe verifikueshmërisë së tyre.

Përfundimisht, Paneli shqyrtues ka vendosur që ankuesin *OE "Sallahu"* të eliminojë si tenderues jo i përgjegjshëm për LOT 2 dhe LOT 4 marrë parasysh numrin e paisjeve të kërkuara në DT, të cilat ankuesi nuk i ka dëshmuar se i ka, kurse meqenëse aktiviteti kthehet në rivlerësim për LOT 1, AK të veproj në përputhje me ligjin për të kërkuar sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP që të sjell origjinalet e dokumenteve të cilave nuk ju vërehet pesha dhe të cilat mund të verifikohen se përputhen me kopjet e bashkangjitura në ofertë, si dhe ti ketë në konsideratë kërkesat e neneve 6 dhe 7, lidhur me nenin 59.4 të LPP.

<u>Pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për Lot 1, 2 dhe 4.</u>

Ankues ka paraqitur edhe pretendime tjera ankimore pohon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit, nuk plotëson kërkesën 4 te kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit në lidhje me përvojën e gjeodetit, nuk plotëson kërkesën 5 të DT se përvoja e inxhinierit të komunikacionit nuk korrespondon me kërkesën e dosjes së tenderit që në këtë rast është ndërtimi, rehabilitimi, apo rikonstruktimi i rrugëve, ka dështuar të përmbushë kërkesën 8 të kapacitetit teknik dhe profesional të njoftimit për kontratë dhe dosje te tenderit. Sipas sqarimit të mësipërm, GOE i rekomanduar për Lot 1 kanë dorëzuar dokumentin e Planit të Menaxhimit te trafikut, ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 10 te Listës se pajisjeve Grejder 12-16t - 3 cope. Lidhur me të gjitha këto pretendime Eksperti shqyrtues i ka pasqyruar në detaje në raportin e ekspertizës i cili është i njohur për palët në procedurë dhe duke ju përgjigjur me arsyetime të cilat gjejnë bazë në dispozita ligjore dhe të cilat i mbështet edhe Paneli Shqyrtues duke i kualifikuar këto pretendimet ankimore si pjesërisht të bazuara.

Ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për LOT 1 nuk plotëson kërkesën për menaxherin e projektit. Lidhur më këtë Eksperti sqaron se në lidhje me procedurat noteriale nuk është kompetent të ekzaminojë aktet e lëshuara nga një noter dhe për çfarëdo dyshimi OE ankues mund të referojë çështjen në institucionin relevant. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar. Paneli Shqyrtues e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues i cili është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës.

Ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 2, GOE i cili nuk ka dorëzuar marrëveshjen për themelimin e grupit në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti sqaron se GOE kanë dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë. Paneli Shqyrtues e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues i cili është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës.

Ankuesi pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 4 OE i cili ka dorëzuar Planin Dinamik të palexueshëm. Lidhur me këtë pretendim ankimor, ekspertit shqyrtues sqaron se plani ofron një pasqyrë të qartë të periudhës së realizimit të kontratës si indikator matës i nën kriterit të planit dinamik me qëllim të vlerësimit të shkallës së peshimit krahas këtij nën kriteri, dhe faktikisht nuk qëndron pretendimi i ankuesit. Andaj, Paneli Shqyrtues e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues i cili është prezantuar në detaje në raportin e tij.

Ankuesi me tej pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar për kontratë për Lot 4, GOE i cili është i papërgjegjshëm dhe duhet te eliminohen nga procedura e prokurimit, pasi qe kanë dështuar që te ofrojnë dështmitë lidhur me Kërkesat e përshtatshmërisë sipas Dosjes se Tenderit, nuk ka dorëzuar marrëveshjen për themelimin e grupit në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Lidhur me këtë pretendim eksperti ka konstatuar se, GOE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dështmitë për themelimin e grupit sipas kërkesave të nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Përkundër që në deklarata shënohet "përfaqësuesit e dy kompanive", marrë për bazë faktin se në kreun e dështmisë përshkruhen emrat e tri kompanive dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe faktit që deklaratat janë nënshkruar dhe vulosur nga tri kompanitë, kurse pjesa e tekstit ku përshkruhet "përfaqësuesit e dy kompanive" mund të konsiderohet një gabim teknik dhe në asnjë rrethanë një pohim i tillë nuk i zhvlerëson deklaratat e dorëzuar nga anëtarët e grupit. Paneli shqyrtues mbështet raportin e eksperti shqyrtues lidhur me ketë pretendim, i cili e ka kualifikuar si të pabazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura ndaj AK, sipas të cilave ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), kur ka rekomanduar për kontratë për Lot 4, GOE i cili nuk e plotëson kërkesën Nr.4 te kapacitetit teknik dhe profesional të DT, lidhur me përvojën e punës për gjeodetin dhe inxhinierin e elektroteknikës. Paneli shqyrtues, për ti sqaruar këto pretendime dhe gjetje të ekspertit më dt.12.03.2024 i ishte drejtuar AK për sqarim e cila me 13.03.2024, ka dorëzuar emalin me sqarimin cituar "Bazuar ne LPP dhe Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 64, [Paraqitja e ankesës dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP], paragrafi 64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Andaj si rezultat i kësaj kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues, qe ne afat sa me të shkurtër kohor te vendoset lidhur me ketë çështje vendimi i AK te mbetet ne fuqi kurse ankesat e OE te hedhen poshtë si te pa bazuara.

Paneli Shqyrtues pas administrimit të provave relevante dhe përgjigjes së dhënë nga AK e cila vë në dukje se pretendimet ankimore nuk janë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe sipas nenit 64.2 të Rregullores, kjo bën që ato të mos jenë të pranueshme për shqyrtim nga paneli shqyrtues.Paneli shqyrtues në bazë të dispozitave ligjore dhe rregullative respektivisht nenin 108/A dhe 109 të LPP-së dhe Rregullores për Prokurim Publik nenin 64.2, vendos që nuk mund të vlerësojë pretendimet ankimore të cilat nuk janë parashtruar në mënyrë të duhur dhe në kohë gjatë fazës paraprake sipas autorizimeve të ligjvënësit, kurse bazuar në nenin 24 të LPP sqaron se autoriteti kontraktues janë përgjegjëse për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.

Ankuesi me tej në pretendimet e tij përshkruan se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP) duke mos e dëshmuar përmbushjen e kërkesave të specifikuara për pajisjet në ofertën e tij. Specifikisht, ai diskuton përkatësisht kërkesat për pajisjet në Listën e Detajuar (DT) për Lotin 4, dhe pretendon se ofertuesi i rekomanduar nuk ka plotësuar këto kërkesa në mënyrë adekuate. Pretendimet e tij janë vlerësuar si të bazuara nga eksperti shqyrtues. Megjithatë, paneli shqyrtues nuk mund të mbështesë ekspertin në tërësi në gjetjet e tij, pasi disa të dhëna që janë përdorur në vlerësim mund të jenë grumbulluar nga uebfaqet e internetit dhe nuk mund të konsiderohen si prova të prera, përderisa komisioni profesional i vlerësimit brenda AK si inicuese e këtij aktiviteti, ka

rekomanduar të njëjtin për kontratë. Andaj, paneli shqyrtues duke u nisur nga fakti se AK gëzon të drejtën me LPP që të vejë në zbatim nenin 59.4 të cilën AK e ka në diskrecionin e tij/saj, dhe meqenëse as OE ankues nuk i plotëson këto pajisje konform kërkesave të DT, vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK për LOT 4, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së.

d) Pohimet ankimore të OE "Graniti" SH.P.K Nr. 0057/2024

Parashtruesi i ankesës – OE Graniti SH.P.K (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1 dhe Lot 4. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me tenderët e OE të rekomanduar për Lot 1 dhe 4.

<u>Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të dhëna nga AK në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar:</u>

OE ankues në pretendimin 1 pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke e eliminuar OE ankues në Lot 1 dhe 4 për pajisje grejder. Lidhur me këtë pretendim Eksperti sqaron se në lidhje me pajisjet Greider, AK ka përcaktuar kërkesën për sasitë të cilat dallojnë sipas Lote-ve. Përkatësisht, për Lot 1 kërkesa është 2 greider me peshën në intervalin 12-16T. Ndërsa për lot 2, 3 dhe 4, janë kërkuar nga 3 greider. Sipas dëshmive të dorëzuara nga GOE vetëm njëri greider (HBM BG 160 TA) plotëson kërkesën për intervalin e peshës 12-16T. Ndërsa për njërin nuk janë paraqitur të dhëna për peshën, dhe sipas AK gjatë hulumtimit në internet është gjetur se plotëson peshën. Andaj, sipas sqarimit të mësipërme sipas dëshmive të dorëzuara GOE ka në dispozicion 4 pajisje prej të cilave 2 tejkalojnë intervalin e peshës sipas kërkesës së AK-së dhe duke marrë për bazë faktin se për Lot 2, 3 dhe 4 janë kërkuar 3 greider, pretendimi ankimor është i pabazuar. Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrë të detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të ofruara për këtë aktivitet të prokurimit dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast, ashtu siç e mbështet edhe konstatimin e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimore lidhur eliminimin e tij/saj sa i përket planit dinamik. Andaj, Paneli Shqyrtues nisur nga administrimi i provave si më sipër dhe shpjegimi i tyre, pa nevojë për ti përsëritur sërish kërkon nga AK që në fazën e ri-vlerësimit për LOT 1, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit ti ketë në konsideratë kërkesat e neneve 6 dhe 7, lidhur me nenin 59.4 të LPP.

<u>Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë për LOT 1 dhe 4</u>

Ankuesi pretendon se AK Autoriteti ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 GOE i cili nuk plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit, ka dështuar të dëshmojë se përmbushë kërkesën për pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës DT, përkatësisht kërkesën 16 te Listës se pajisjeve, Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur), min. 6.5 t, ka dorëzuar të dhëna të pasakta në listën e kontratave të realizuara. Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura ndaj AK se ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1. Paneli Shqyrtues vendos konform dispozita ligjore që mos të lëshohet në vlerësim të pretendimet ankimore të cilat nuk janë parashtruar me kohë gjatë fazës paraprake sipas autorizimeve të ligjvënësit ne kuptim të nenin 108/A dhe 109 të LPP-së lidhur me nenin

64.2 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nga OE ankues dhe të njëjtat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi pranë OSHP. Edhe pse Paneli Shqyrtues sqaron se shumica e këtyre pretendimeve ndaj OE të rekomanduar për kontratë për LOT 1 janë shqyrtuar në pretendimet ankimore të OE tjerë ankues.

Ankuesi pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP), pasi që GOE i rekomanduar për kontratë për Lotin 4 ka dorëzuar dokumente në gjuhën sllovene, duke shkelur kështu nenin 13 të LPP-së. Gjithashtu, pretendohet se 3 kontrata nga lista e prezentuar janë në vazhdime dhe nuk duhet të merren parasysh. Paneli vëren se këto pretendime janë analizuar në mënyrë të detajuar nga eksperti dhe janë të bazuara në dokumentacionin e ofruar për këtë aktivitet të prokurimit, duke u referuar njëherësh edhe interpretimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) në lidhje me çështjen e gjuhëve dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast. Për sa i përket pretendimeve të tjera të ankuesit lidhur me listën e kontratave, paneli sqaron se nuk ka ofruar prova konkrete dhe bindëse. Nga ana tjetër, eksperti nuk ka bërë ndonjë konstatim se lista e kontratave e ofruara nga OE e rekomanduar nuk përmbush kërkesave e DT. Si rezultat, paneli shqyrtues duke marrë parasysh se ankuesi nuk është përgjegjshëm për Lotin 4 dhe duke u nisur nga parimi i proporcionalitetit nuk gjen arsye të mjaftueshme që të eliminojë OE të rekomanduar dhe të anuloj një vendim të një AK, i cili është përgjegjës, iniciues dhe zbatues i kontratës në tërësi.

e) Pohimet ankimore të GOE "Ndërtimi Ing SH.P.K.; N.N.SH. World Medium; Adnan Bislimi B.I.; Adea Construction SH.P.K.; Agim Morina B.I.; Riviera Company 2008; Ndregjoni SH.P.K" Nr. 0058/2024

Parashtruesi i ankesës (më te dhëna si më lartë) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të GOE ankues dhe të njëjtat janë paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim.

Ankuesi në pretendimin 1 pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën për gjendjen ekonomike dhe financiare pika 2. Në lidhje me këtë pohim, eksperti sqaron se sipas dëshmive të dorëzuara nga GOE, anëtari "Ndërtimi ING SHPK" ka mjete të gatshme 584,326.74 euro në bankën TEB, ndërsa në bankën Raiffeisen ka mjete 315,291.74 euro, kredi të aprovuar rreth 100,000.oo euro, mbitërheqje 5,000.oo euro. Pra anëtari i grupit "Ndërtimi ING SHPK" kishte mjete në llogari 899,618.48 euro si dhe 105,000.oo euro kredi dhe mbitërheqje të aprovuar. Anëtari tjetër BURIM ZABELAJ BI (World Medium) sipas dëshmive të dorëzuara kishte mjete të gatshme 331,070.74 euro, 90,000.oo (prej tyre 60,187.oo shënohet risku) dhe 5,000.oo limiti i kredit kartelës. Ndërsa në Bankën Ekonomike kishte 543,878.57 euro mjete në llogari si dhe kredi të aprovuara 200,000.00 euro, mbitërheqje 290,000.oo euro dhe kreditë kartelë 10,000.oo euro. Pra anëtari BURIM ZABELAJ BI (World Medium) kishte gjithsej mjete në llogari 874,949.31 euro, dhe qasje në kredi, mbitërheqje dhe kreditë kartelë në vlerë prej 505,000.00, duke mos llogaritur pjesën e kredisë në bankën TEB ku një pjesë është evidentuar si risk. Pra, sipas dëshmive të dorëzuara GOE plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, pika 2, përfshirë edhe kushtin prej minimum 40% të shumës për liderin e grupit. Në rast të dyshimit të kushtëzimeve apo cilitdo dyshim në lidhje me këtë kërkesë (por pa u kufizuar vetëm në këtë kërkesë) konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së, AK do të kryejë një

kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë. Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrë të detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të ofruara për këtë aktivitet të prokurimit dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast.

OE ankues në pretendimin 2 thekson se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën planin dinamik. Lidhur me këtë pretendim, eksperti sqaron se Plani dinamik është kërkesë e vendosur nga AK në aneksin 1 të dosjes së tenderit në kuadër të kritereve të propozuara të kriterit për dhënie të kontratës, përkatësisht si nënkriter i përcaktuar nga AK në aneksin 6 të dosjes së tenderit me qëllim të përzgjedhjes së OE sipas kriterit tenderi me çmimin ekonomikisht me i favorshëm. Formulimi i kërkesës është relativ dhe jo i qartë e aq më tepër duke përdor fjalën "sa më i detajuar i mundshëm", pra duke e lënë në mundësinë e OE-ve që sipas mundësisë së tyre të thellohen në detaje. Më tej mënyra e formulimit të kriterit "Planin dinamik më i shkurtë dhe më mirë i detajuar." krijon përshtypjen që kriteri vlerësohet në dy nënndarje, fillimisht sa më i shkurtë për nga afati kohore dhe pjesa e dytë sa më mirë që është i detajuar. Sipas tabelës së poentimit të dërguar nga AK, gjatë vlerësimit është marrë për bazë vetëm afati kohor i deklaruar nga OE-të për realizimin e punëve në lotin përkatës. Andaj, duke marrë për bazë një formulim të tillë i cili për AK është subjektiv në kuptimin e vlerësimit të këtij kriteri, si dhe faktit që OE ka dorëzuar një plan i cili mund të konsiderohet më pak i detajuar mirëpo i cili jep një pasqyrë të qartë të indikatorit vlerësues "kohë", prandaj çështja e aspektit "sa më i detajuar" është vlerësim subjektiv. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar. Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrë të detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të ofruara për këtë aktivitet të prokurimit dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast, Rrjedhimisht OE ankues të përfshihet në fazën e ri-vlerësimit për LOT 1, pasi që pretendimet ankimore të ankuesit kanë qenë vetëm për LOT 1.

f) Pohimet ankimore të GOE "N.N. 100 % Design Sh.P.K.; Haxha Kom Sh.P.K.; Haxha Company Sh.P.K.; Integral Sh.P.K.; Milenium Konstruction Sh.P.K.; Capital Sh.P.K", Nr. 0059/2024

Parashtruesi i ankesës (më tej GOE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 03.01.2024, përderisa AK me datë 09.01.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. GOE ankues ka dorëzuar ankesë për Lot 1, 2, 3 dhe 4. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të GOE ankues dhe të njëjtat janë paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim. Në këtë ankesë gjithashtu janë paraqitur pretendime ankimore në lidhje me OE-të e rekomanduar për Lot 1 dhe 4.

Në pretendimin 1 Ankuesi me të dhëna si më sipër, pohon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën për kapacitetin ekonomik dhe financiar numër 2, të dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë pretendim eksperti sqaron se në konstatimin e AK se GOE nuk plotëson këtë kërkesë nuk është dhënë asnjë sqarim konkret se cilin element dështmia e dorëzuar nuk plotëson kërkesën. Sipas dështmisë së dorëzuara GOE plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, pika 2, përfshirë edhe kushtin prej minimum 40% të shumës për liderin e grupit, duke marrë për bazë deklaratën nga banka për

mundësinë e financimit deri në dy milion euro. Në rast të dyshimit të kushtëzimeve apo cilitdo dyshim në lidhje me këtë kërkesë (por pa u kufizuar vetëm në këtë kërkesë) konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP-së, AK ka mundur të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Në pretendimin 2, Ankuesi pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur se OE ankues nuk plotëson kërkesën planin dinamik. Në lidhje me këtë pretendim , eksperti sqaron se pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Ankues në pretendimin 3 pohon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së dhe nenin 59 të LPP-së kur ka vendosur se GOE ankues nuk plotëson kërkesën për pajisjet dhe mekanizmat. Në lidhje me këtë pretendim eksperti sqaron se konstatimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përbën pasaktësi në lidhje me pajisjet pasi që GOE ankues nuk ka dorëzuar dëshmi për pajise të tilla. Më tej eksperti sqaron se nga dëshmitë e dorëzuara nga GOE ankues për 5 pajisjet – Greder, pesha e tyre nuk është në intervalin e peshës sipas kërkesës së AK-së në aneksin 1 të dosjes së tenderit (12-16T). Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrën e detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të DT dhe ofertës dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në ketë rast. Andaj, në bazë të këtyre konstatime OE ankues lidhur me Kërkesën e pajisjeve për grejder në të cilën që të gjithë janë jashta intervalit së peshës së kërkuar nga AK, atëherë rezulton se OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit nuk është i përgjegjshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura ndaj AK se ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 të LPP duke rekomanduar për kontratë për Lot 1 dhe 4. Paneli Shqyrtues vendosi konform dispozita ligjore që mos të lëshohet në vlerësim të pretendimet ankimore të cilat nuk janë parashtruar me kohë gjatë fazës paraprake sipas autorizimeve të ligjvënësit ne kuptim të nenin 108/A dhe 109 të LPP-së lidhur me nenin 64.2 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik nga OE ankues.

Paneli shqyrtues, pasi ka vlerësuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga ofertuesit dhe arsyet e eliminimit të tyre, vëren se të gjithë ofertuesit ankues kanë pasur të meta në pajisjet e ofruara në ofertat e tyre. Kjo gjë ka nxitur nevojën për një analizë të hollësishme për të vendosur përjashtimin e tyre nga procesi i prokurimit. Nga ana tjetër, sipas legjislacionit aktual, në nenin 59.4 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), AK ka të drejtë të konsiderojë disa prej këtyre devijimeve në pajisjet e ofruara si "devijime të vogla". Në këto rrethana, AK ka ushtruar diskrecionin e saj në përputhje me dispozitën e cituar më sipër, duke i pranuar si devijime të vogla disa nga to. Nga ana tjetër ofertuesit ankues për LOT 2,3 dhe 4 nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte dhe prova konkrete se kanë ofertuar në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të kërkuara në DT dhe NJK. Prandaj paneli shqyrtues ka vendosur të pranojë dhe të respektojë këtë vendim të AK-së për këto LOT-e. Ky vendim është nxjerrë nga një komision i vlerësimit brenda AK-së, i cili supozohet të jetë profesional dhe të ketë përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, bazuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Përveç kësaj, paneli shqyrtues thekson se, në përputhje me nenin 8 dhe 9 të LPP-së, çdo autoritet kontraktues, siç është AK në këtë rast, gëzon autonomi për të planifikuar

dhe përcaktuar nevojat e prokurimit në përputhje me kapacitetin buxhetor. Bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP-së, që i jep AK-së përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të ekzekutohen në përputhshmëri me ligjin.

Përfundimisht paneli shqyrtues, në përputhje me nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje (në pafundësi), paneli shqyrtues ka vendosur të pranojë vendimin e AK-së dhe ta lejojë atë të mbetet në fuqi pëe LOT 2, 3 dhe 4. Ky veprim u bë në të mirë të qytetarëve të vendit në përputhje me nenin 104.4 të LPP-së."

- *Përfundim –*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët konsideron se shumica e gjetjeve të ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28 dhe 56 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me "kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit" për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili nuk posedojnë "pajisjet" me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK, lidhur me pranueshmërinë e pajisjeve të cilat ofertuesit i kanë aktualisht në posedim e që sipas kritereve te vendosura në DT nuk përputhen mes vete, nga ana tjetër paneli sqaron se në asnjë rrethane [kjo e metë e gjetur në ofertat e ankueseve lidhur me specifikacionin teknik nga AK] nuk mund të sqarohet tani në procedurën e vlerësimi pranë komisionit profesional, përveç nëse të njëjtit paraqesin ndonjë dëshmi/prove se i posedojnë pajisjet pikërisht sipas DT, duke hedhur posht njëherësh te gjitha arsyet e eliminimit, të cilat janë renditur në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar nga AK, për secilin ankues, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen sërish

në detaje.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret për LOT 1, 2 dhe 3, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret, ndërsa për LOT 4, Paneli Shqyrtues nuk e mbështeti rekomandimin e ekspertit shqyrtues në tërësi në gjetjet e tij, pasi disa të dhëna që janë përdorur në vlerësim janë grumbulluar nga uebfaqet e internetit dhe nuk mund të konsiderohen si prova të prera, si dhe disa pretendime nuk kanë qenë të njëjta si në kërkesë për ri-shqyrtim sipas përgjigjes së AK, përderisa komisioni profesional i vlerësimit brenda AK si inicuese e këtij aktiviteti, ka rekomanduar të njëjtin për kontratë. Andaj, paneli shqyrtues duke u nisur nga fakti se AK gëzon të drejtën me LPP që të vejë në zbatim nenin 59.4 të cilën AK e ka në diskrecionin e tij/saj (devijimin e vogël), dhe meqenëse edhe OE ankues kanë mangësi në plotësim të kërkesave të DT, në kuptim të nenit 1 dhe 7 të LPP vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK për LOT 2, 3 dhe 4, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe përgjegjës konform nenit 59 par. 1 te LPP-së. Ndërsa LOT 1 kthehet në ri-vlerësim.

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kërkesa e ankuesit për plotësimin e dokumentacionit lidhur me makinerinë e tij/saj nuk duhet të shihet si një arsye e vlefshme për të ndërhyrë në procesin e prokurimit në mënyrë të pamjaftueshme të arsyeshme. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara.

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit, kurse kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP. Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e

kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- OE - **N.P.,,Victoria Invest International Sh.p.k., "SALLAHU" SH.P.K., Granit SH.P.K., N.N. 100 % Design Sh.p.k., NDËRTIMI ING SH.P.K., RSM Company SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: